

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Flamingot dhe hiperpolitika e të ndjerit të rëndësishëm
ADRESA	https://www.gazetatema.net/editorial/flamingot-dhe-hiperpolitika-e-te-ndjerit-te-rendesi-shem-i587080
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 12:49:36 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 15:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ec7b94b30feb234ea539a3ef714e4cdb2b38a65690178518286e02e6219cbaa1
TEKSTI	265b0f99eee2596af96d1b628ab3691bf9219c754fff65479216fa84923d4589
PAMJA	3f2d7d091f10d4d1d077ecb47bbc7f2a8dd847e1be046c1cbee6e33af4ba12bf

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a46f519fe627e0f667dc549a6a1ce68f18bf61dc0c208b84487e77508c5827b7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a46f519fe627e0f667dc549a6a1ce68f18bf61dc0c208b84487e77508c5827b7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 English

Built and Monetized by  [Kontakt](#)

 English

1 e Danimarka: Groenlanda nuk heq dore nga sovraniteti i saj pas marreveshjes me SHBA-ne t'urqia rrit presionin ndaj Greqise: Kerkon serish çmilitarizimin e ishujve t'irra fundit

Flamingot dhe hiperpolitika e të ndjerit të rëndësishëm



19 Shtator 2026, 17:00 Editorial Bjorn Runa

Ndërsa kanë kaluar më shumë se njëqind ditë nga nisja e saj, protesta ‘Flamingo’ sa vjen dhe ngjan me një lëvizje që është bërë më tepër e domosdoshme për pjesmarrësit e saj, sesa ndonjë kërcënim për qeverinë. Sherret e brendshme mes zërave më prominentë të saj, së bashku me takimet diskrete, të japin përshtypjen se po përgatitet diçka me pasoja të mëdha – organizatorët duket se e besojnë seriozisht këtë – por ajo çfarë vjen më pas, në të shumtën e rasteve është tepër larg një aksioni me pasoja politike.

Natyrisht, nuk filloi kështu. Mobilizimi rreth projekteve turistike në Sazan dhe Zvërnec sifdoi për pak ditë bindjen se pasuria publike mund të trajtohet material për investime private dhe pjesmarrësit në protestë kishin realisht arsye të ndiheshin të rëndësishëm, pasi po krijonin një situatë problematike për qeverinë. Por, vetëndjerja të rëndësishëm rezultoi më jetëgjatë se sa presioni që e prodhoi atë dhe që në fakt, nga kërcënim për qeverinë, rrezikon të kthehet në diçka favorizuese për të.

Historiani belg Anton Jäger jep një shpjegim të vlefshëm të “Hiperpolitikës”, ku përshkruan se si shoqëri tona sot, ndonëse të rrethuara ngado nga politika dhe në mobilizim konstant, mbeten të pafuqishme për t'i ndryshuar realisht gjërat sepse njerëzit mobilizohen më lehtë rreth një zemërimi të çastit sesa rreth një organizimi të përbashkët afatgjatë. Kështu, mobilizimi mund t’u japë njerëzve një rol, njohje dhe bindjen se po bëjnë diçka me rëndësi, pa u dhënë domosdoshmërisht fuqinë për ta ndryshuar me të vërtetë atë që kundërshtojnë.

Analiza e tij përqëndrohet thuhetse ekskluzivisht tek shoqëritë Perëndimore, por paradoksi i mobilizimit të vazhdueshëm dhe kudondodhjes së politikës, mund të ekstrapolohet edhe në shoqëri si e jona, ku një lëvizje si ajo e Flamingove po e humbet dita-ditës ndikimin mbi qeverinë, ndërkohë që bëhet gjithnjë e më rëndësishme për njerëzit që marrin pjesë në të. Protesta përcakton role për gjithsecilin në shesh, duke iu dhënë përgjegjësi dhe një audiencë që i dëgjon e i duartroket, shpesh pa kuptuar as çfarë po thuhet dhe çfarë synohet të arrihet.

Dështimi për të arritur rezultate konkrete nuk i pengon organizatorët që të përmirësojnë pozitën brenda ‘rrethit të protestës,’ çka shpjegon atmosferën gati-gati klandestine që rrethon disa prej zërave më publikë të saj. Fshehtësia krijon një hierarki mes atyre që e dinë se çfarë po përgatitet dhe atyre që duhet të presin, duke u dhënë të parëve autoritet brenda grupit. Në mungesë të rezultateve, të qenët pjesë e një takimi të mbyllur bëhet vetë provë rëndësie, edhe nëse prej tij nuk del asnjë vendim me peshë.

Por, pas kaq muajsh, është e vështirë që vetë ‘Flamingot’ të vënë në pikëpyetje orientimin e protestës, sepse shumëkush brenda saj do ndihet i ofenduar pas një përkushtimi kaq të gjatë. Ndaj, e kanë më të lehtë të mbrojnë vijimësinë e saj duke kujtuar sakrificat e bëra, sesa të pranojnë se gjithë ajo përpjekje mund të kërkojë një drejtim tjetër.

Tani rreziku qëndron në faktin se është bërë më e vështirë për pjesmarrësit të largohen nga lëvizja, sesa për qeverinë që ta injorojë atë. Ndaj, mund të thuhet se vazhdimësia e saj po i shërben më së miri, njëkohësisht, të dy palëve. Udhëheqësit e Flamingove mund të vijnë të ndihen të rëndësishëm, ndërsa qeveria mund ta paraqesë praninë e tyre të përnatshme në shesh si dëshmi të tolerancës së vet demokratike. Ja ku protestojnë, askush nuk i pengon; nëse nuk arrijnë gjë, kush jua ka fajin veç vetes? Dhe e nesërmja mund të vazhdojë t’i ngajë të sotmes, sa kohë dikush del në podium dhe shpall se po jetojmë një tjetër ditë historike.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Ra ky mort e gjyqtarët po mësojnë rrogat e tyre](#)

17:56 Editorial / 49 komente

Përse gëzohen sot "Kasandrat" e Gjykatës Speciale

18:36 Editorial / 71 komente

Mos ia vrisni Hashim Thaçit Kosovën që fitoi me luftë

19:46 Editorial / 54 komente

E vetmja gjë që nuk ka ndryshuar është përndjekja politike ndaj Erion Veliajt

16:56 Editorial / 65 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.